



Prishtinë: 30.06.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_199\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_214\_05\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_214\_05\_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 09.06.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2009 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Mehdi Shala (shifra e konsumatorit DPR – 22029) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 27.04.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 21.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 13.11.2008 me kërkesën e Konsumatorit ekipi inspektues i KEK-ut ka inspektuar pikën matëse të konsumatorit, kjo ekip ka sugjeruar që ky njehsor duhet të dërgohet në laboratorin e kalibrimit për ekspertizë të brendshme të njehsorit për arsye se kapaku i epërm i njehsorit është i shpuar në drejtim të diskut të njehsorit .  
**Provë:** Procesverbali nr 0143176 të datës 13.06.2008
- Me datë 28.08.2008 zyrtarët e KEK-ut kanë hequr nga matja e energjisë elektrike njehsorin me nr 4692926 dhe kanë vendosur njehsorin për matjen e energjisë elektrike me nr. 4242699.  
**Provë:** Procesverbali për ndërrimin e njehsorit të datës 28.08.2008

- Me datë 16.12.2008 Qendra e laboratorit të kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 4692926 dhe ka konstatuar se përmes vrimës është penguar puna e diskut.  
**Provë:** Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr. 18/06 të datës 06.12.2008
- Me datë 16.03.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR09HP07393 në shumë prej 1,758.51 €  
**Provë:** Fatura DPR09HP07393 të datës 16.03.2009
- Me datë 06.04.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.  
**Provë:** ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 21.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën , duke u thirrur në faktet dhe argumentet e paraqitura ne përgjigje.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 21.04.2009
- Me datë 27.04.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 13.05.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 13.05.2009
- Me datë 09.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_214\_05\_09.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_214\_05\_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Ve

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar